

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, (e vendosur në objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), si gjykatë kontestimore e përberë nga gjyqtari individual Faton Ademi , në çështjen juridike të paditesit: nga Mitrovica të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. nga Mitrovica kundër të paditurve: nga Mitrovica të cilin e përfaqësoi pasardhësi i tij përfaqësuesi i përkohshmë Av. dhe tē cilët i përfaqëson si dhe të paditurve tjerë: përfaqësuesi i përkohshëm Av. nga Mitrovica, baza e tē cilët i përfaqëson kontestit: vërtetim pronësie, pas mbajtjes së seancës së datës: 12.12.2013 në prezencën e palëve- përfaqësuesve të tyre, me datë: 23.12.2013 bie këtë:

### A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e BAZUAR dhe
- II. **VËRTETOHET** se paditësi . . . . . është pronar mbi bazën e shitblerjes dhe mbajtjes me mirëbesim për më shumë se 20 vite të pjesës së ngastrës kadastrale 2798-1 me sipërsaqe prej 857 m<sup>2</sup>, pjesës së parcelës kadastrale 2798-13 me sipërsaqe prej 25 m<sup>2</sup> si dhe pjesës së ngastrës kadastrale 2798-16 me sipërsaqe prej 2 m<sup>2</sup>.
- III. **OBLIGOHEN** të paditurit që këtë të drejtë t'ia njohin paditësit si dhe të njëjtit t'ia lejojnë rexhistrimin e kësaj të drejtë në rexhistrat kadastral, në të kundërtën ky aktgjykim do t'i shërbej të njëjtit si bazë për rexhistrim në rexhistrat përkatës kadastral
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

### A r s y e t i m

Paditesi me date. 03.06.2009 ka parashtruar në gjykatë padi përvërtetimin e pronësës kundër të paditurve.

Gjykata edhe pse tentoi në disa forma që të kontaktojë me të paditurit, mirëpo përpjekje a e gjykatës ishte e kotë pasi të njëjtit gjenden jashtë territorit të Kosovës.

Pas shterrjes së mjeteve adekuate gjykata të paditurve tjerë me përjashtim të të paditurit të parë pasi u plotësuan kushtet ligjore ua

LAKUOI PËRFAQESUESEN E PËRKOMISIONI TE CHER UU TË PËRFAQESORINI MIRËSAL TË PADITURVE NË KËTË QËSHTE KONTESTIMORE.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit deklaroj se i propozon gjykatës që konform ekspertizës së ekspertit të gjeodeziës të vërtetoj se paditësi është pronar mbi bazën e shitblerjes gojore dhe mbajtjes me mirëbesim i pjesës së parcelave të cituara si në pikën II të dispozitivit.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve: II, III dhe IV deklaroj se i propozoi gjykatës që në harmoni me provat e amdinistrauar në shqyrtimin kryesor të bjen aktgjykim përkatës në lidhje me këtë qëshje.

Përfaqësuesi i përkohshmë i të paditurve: V, VI dhe VII në fjalën përfundimtare deklaroj se në bazë të rezultatit të provave të nxjerrura gjatë shqyrtimit gjyqësorë si

Sa i përket të paditurit të parë gjykata ka dëgjuar pasardhësin e tij pasi i padituri i parë ka vdekur, i njëjtë ka deklaruar se pronën në fjalë babai i tij ia ka shitur paditësit, kjo i kujtohet se i ka thënë prindi i tij.

Me qëllim të vërtetimit sa më të plotë të gjendjes faktike gjykata administroi këto prova: lajmërimi mbi vërtetimin e stazhit pensional lëshuar nga ish-BVI-a me numër 825/78 të dt.26.04.1979, certifikatat mbi të drejtat e pronës me numër UL-71208072-01274 që ppërfshin parcelat me numër: 02798-1, 02798-13, 02798-16, 02798-9, 02798-0, 02800-0, 02802-1, 02802-2, 02802-3 dhe 02802-4, ekstrakti i nxjerrur nga libri i ish Elektro- Kosmeti rreth gjendjes mujore i vitit 1997, fatura c postës 01.12.1999, dëshmia lëshuar nga Komuna e Mitrovicës e dt.24.09.2012, kërkesa drejtar ish Habitati si dhe përgjigjet e lëshuara nga ky organ, fotodokumentacioni i shtëpisë së paditësit, kopja e letërnjoftimit për paditësin i dt.29.04.1997, leja e vozitjes e dt.23.05.1994.

Provat e administruara gjykata i vlerësoi një nga një dhe të gjitha sëbashku konform dispozitave ligjore, dhe pas kësaj erdhi në këto përfundime:

Nuk është kontestuese se paditësi ka banuar në atë vend para luftës, ku ky fakt vërtetohet si nga ljamërimi mbi stazhin pensional i vitit 1979 e cila i referohet paditësit personalisht dhe atë në adresën ku gjendet paluajtshmëria kontestuese.

Sa i përket qëshjes së shitblerejes këtë fakt e vërtetuan 3 dëshmitarët e dëgjuar në këtë qëshje: .  
lhe

i, që të gjithë deklaruan se paditësi këtë prone e ka blerë pas vitit 1970, dhe rreth vitit 1974-1975.

Që të gjithë dëshmitarët e dëgjuar deklaruan se që nnga ajo kohë paditësi ka hyrë në posdim dhe atë asnjëher askush nuk e ka penguar në shfrytëzimin e lirë të kësja pjesë.

Faktin se paditës ka banuar në ëta vend dhe se aty e ka pas të ndërtuar shtëpinë e vërteton prova-vërtetimi i lëshuar nga Komuna e Mitrovicës, pastaj përgjigjet-shkresat e ish habitatit tani Agjencionit Kosovar të Pronës.

Edhe dokumentet personale të paditësit si kpja e letërnjoftimit dhe lejës së paditësit i referohen adresës ku gjenden prona tani kontestuese.

Nga cikspertiza e ekspertit të gjeodeziës si dhe nga dalja e gjykatës në vend u vëretua pjesa që e mban paditësit, si dhe shihc qartë edhe murci e djegura të shtëpisë.

Eksperti në mendimin e tij me shkrim vërtetoi se paditësi në teren mban pjesë së ngastrës kadastrale 2798-1 me sipërfaqe prej 857 m<sup>2</sup>, pjesës së parcelës kadastrale 2798-13 me sipërfaqe prej 25 m<sup>2</sup> si dhe pjesës së ngastrës kadastrale 2798-16 me sipërfaqe prej 2 m<sup>2</sup>.


Sa i përket të drejtës materiale gjykata bazohet në Ligjin Mbi Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, nen 40 i cili thotë: "Personi i cili me mirëbësim e ka njëzetë (20) vjet në posedim të pandërpërre një paluajtshmëri ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të".

Në rastin konkret paditësi është mbajtësi me mirëbesim, pasi i njëjti pronën në fjalë ka blërë mirëpo asnjëher nuk e bartur në emër të tij, ndërsa pronën në fjalë e mban më tepër se 20 vite, pra janë plotësuar dy kushtet të cilat kërkohen me këtë dispozitë ligjore.

Aktgjykimi u bazua në nenin 143 të LPK-së

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.nr.85/2009 Datë: 23.12.2013**

**G J Y Q T A R I**  
**Faton Ademi**



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa ne afat prej 15 dite nga data e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.